

## **Punë kërkimore antropologjike në zonën e Dhërmiut/Drimades të Himarës**

Nataša Gregorič Bon, M.Sc (Përktheu Juliana Vera dhe Nevila Koçollari Furxhi)

Instituti i Antropologjisë dhe të Studimeve të Hapsirës

Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë Slovene të Shkencave dhe Arteve

[Natasa.gregoric@zrc-sazu.si](mailto:Natasa.gregoric@zrc-sazu.si), [www.zrc-sazu.si](http://www.zrc-sazu.si)

Në prezantimin tim do përpiqem të paraqes disa nga vezhgimet dhe mendimet e mia të mbledhura gjatë 12 muajve të punës kërkimore shkencore antropologjike në fshatin Dhërmi/Drimades në zonën e Himarës. Së pari, më lejoni t'ju sqaroj që do t'i referohem termave Dhërmi dhe Drimades, pasi të dy këto terma janë përdorur nga banorët e zonës në fjalë. Së dyti, si shkollare e antropologjisë sociale dhe kulturore, një disiplinë e bazuar në studimin e zakoneve, traditave, besimeve, veprimeve dhe shprehjeve të shoqërisë dhe grupeve të veçantë, unë orientohem të përdor konceptet dhe përparësitë që janë pjesë e një diskutimi në nivel lokal. Gjatë historisë së shkencave sociale, ndodh shpesh që konceptet shkencore për grupe sociale të veçanta, janë shumë të ashpra kur shprehin ose përshkruajnë »çfarë ndodh në të vërtetë« në një komunitet specifik të marrë si subjekt studimi. Në kuadrin e shkencave sociale, antropologjia, përpiqet të shmangë përdorimin e koncepteve zyrtare (politike apo akademike) të cilat mund të jenë të papërshtatshme për të përshkruar kuptimin e emrave dhe koncepteve që cilësojnë zonën.

Termi antropologji vjen nga një fjalë Greke. *Anthropos* – njeri dhe *logos* – shkencë. Kështu antropologjia është një shkencë humane e përqëndruar në zakonet, traditat, arsyen, jeten e përditshme, praktikat dhe shprehjet e një shoqërie ose komuniteti të veçantë, shpeshherë të vogël në numër. Në kuptimin më të gjerë, është studimi krahasues i kulturës dhe shoqërive (Keesing dhe Strathern 1998: 4).

Antropologjia përbëhet nga tre degë të rëndësishme dhe të ndërlidhura që formojnë të ashtuquajturin trekëndësh antropologjik: a) etnografia b) krahasimi c) kontekstualizimi (shih Sanjek 1998: 193).

Ad. a) Etnografia bazohet në një punë kërkimore shkencore antropologjike afatgjatë që drejtohet nga metoda e vëzhgimit pjesëmarrës. Kjo do të thotë që antropologu duhet të jetojë me njerëzit që ai/ajo ka zgjedhur si subjekt të studimit të tij/saj, të mësojë gjuhën dhe mënyrën e tyre të jetuarit. Antropologut i bëhet rutinë mbledhja e të dhënave që përbëhet nga: regjistrimi i popullsisë, regjistrimi i gjenealogjisë, të kuptuarit e rolit të personazheve vendas, të pyeturit e informantëve rreth çështjes së zakonit dhe besimit (shih Keesing dhe Strathern 1998: 8-9). Të gjitha këto antropologu i shënon në shënimet e punës kërkimore shkencore të tij/saj që do t'i shërbejnë për sinteza të mëtejshme.

Ad. b) Krahasimi është këndi i dytë i trekëndëshit antropologjik. Shënimet e punës kërkimore shkencore të mbledhura filtrohen dhe interpretohen nga krahasimet e tyre me etnografi të tjera lidhur me tema kërkimore të ngjashme. Pasi drejton punën kërkimore shkencore, antropologut i duhet të lexojë etnografi të ndryshme dhe të supozojë (hipotetizojë) një teori krahasuese që sugjeron probleme dhe interpretime të reja për t'u zgjidhur gjatë punës kërkimore shkencore etnografike të mëtejshme.

Ad. c) Kontekstualizimi si këndi i fundit i trekëndëshit antropologjik bazohet në vendosjen e teorive dhe krahasimeve në një kontekst antropologjik më të gjerë.

Në këtë sens antropologjia është e interesuar në »kërkimin e përgjithësimeve dhe teorive rreth sjelljes sociale humane dhe kulturave« (Keesing dhe Strathern 1998: 4). Përveç kësaj antropologjia gjithashtu mund të shërbejë për qëllime të zbatueshme. Antropologjia e zbatuar shpesh prezantohet si mjet që lidh vendasit dhe institucionet zyrtare ose organizatat që punojnë midis tyre. Për shembull, projektet e hartuara nga organizata ose institucione të ndryshme, të destinuara për zhvillimin e zonës (rinovimi dhe ruajtja e trashëgimisë, duke zhvilluar turizmin) kërkojnë një studim parapërgatitor që mund të bëhet nga antropologët.

Puna kërkimore shkencore afatgjatë është një pjesë e rëndësishme e punës kërkimore antropologjike. Ajo varet nga tema e punës kërkimore të studiuesit në vëndin, kontinentin e veçantë që ai/ajo pëlqen ose zgjedh thjesht rastësisht. Unë zgjodha të bëj studimin tim në fshatin Dhërmi/Drimades, Bashkia Himarë, bazuar në rastësinë e një bisede të këndshme me kolegen time të frymëzuar nga vizita e saj turistike në Shqipëri. Pas disa muajsh të punës sime kërkimore në Dhërmi/Drimades nuk mund të besoja se si kjo rastësi dhe kurioziteti im u interpretua në sytë e disa vendasve të cilët e panë punën time si pjesë të spiunazhit politik. Edhe pse isha disi e përgatitur për këto lloj keqkuptimesh të rolit tim në një komunitet të izoluar, nuk u ndjeva mirë. Për t'a ndryshuar gjendjen time dhe për ta patur më të lehtë punën, vazhdimisht ngushëlloja veten me eksperiencën e punës kërkimore të mëparshme, në një nga ishujt e Papua në Guinenë e Re. Atje roli im si studiuese, që shpesh bënte pyetje të çuditshme (si p.sh. çfarë hani dhe si visheni dhe shumë pse-ra të tjera të çuditshme) u kuptuan ndryshe. Njerëzit atje mendonin se unë isha shpirti i stërgjyshërve të tyre. Këto lloje perceptimesh, arsyesimesh dhe reagimesh të »Tjetrit« (antropologu) janë diskutuar gjerë në teorinë antropologjike nga studiues të ndryshëm si Eriksen 1993 Gupta dhe Ferguson 1997 dhe të tjerë. Koncepti i »Tjetrit« si person i panjohur, jofamiljar, atipik dhe i huaj, shpesh është krijuar dhe kuptuar në kontrast me konceptin »Ne«, i cili është i njohur, familjar, tipik dhe popullor. Në këtë sens, roli im si antropologe femër e re, e martuar, dhe pa fëmijë e cila erdhi të jetonte vetëm me njerëzit dhe të bëhej pjesë e të përditshmes, ishte diçka jo tipike, jo familjare dhe e pazakontë për Dhërmiasit/Drimadiotes.

Të kuptuarit e rolit të antropologut shpesh është pjesë e rëndësishme e punës kërkimore antropologjike që e ndihmon atë të kuptojë kontekstin më të gjerë social dhe kulturor të njerëzve që ai/ajo po studion. Prandaj antropologu duhet të përqëndrohet në atë çfarë vendasit duan t'i thonë dhe si duan ata/ato të përfaqesojnë veten e tyre. Kur antropologu nis punën kërkimore, duhet të bëjë një plan paraprak, që më pas duhet ta »harrojë« pasi i duhet të fokusohet në fjalët dhe veprimet konkrete të njerëzve. Me fjalë të tjera ,antropologut i duhet të zbulojë »çfarë në të vërtetë po ndodh«. Kështu, kur unë erdha në Dhërmi/Drimades m'u desh të »harroja« planin kërkimor që i referohej studimit social dhe kulturor të perceptimit të vendit dhe hapësirës në Dhërmi/Drimades. Në planin tim unë pyesja veten se si Dhërmiasit/Drimadiotes perceptojnë, shprehin dhe lidhin rolin e vendit dhe peizhazhit ku ata jetojnë, banojnë dhe udhëtojnë, me vetë jetën e tyre. Në teorinë antropologjike të vendit dhe hapësirës, dihet gjerësisht se prezantime të tilla të vendit dhe peizhazhit në një rajon, shpesh mund të jenë ndryshe nga prezantimet politike ose kombëtare, të cilat janë në shumë kontekste (sidomos në kontekstet paskoloniale dhe paskomuniste) jetohen dhe mendohen si të pakontestueshme. Antropologjia si disiplinë

njerzore përpiqet të ekspozojë të tilla gabime arsyetimi me qëllim që të shmangë konflikte të cilat ndonjëherë mund të kthehen në tensione serioze kulturore, sociale, historike ose politike.

Në Dhjetor të 2004 kur erdha në Dhërmi/Drimades e fillova punën time kërkimore me mbledhjen e të dhënave të regjistrimit të popullatës. E bëra këtë gjë me qëllim që të studioja strukturën sociale (sistemi i farefisnisë) dhe t'ja prezantoja veten dhe punën time kërkimore komunitetit lokal. Ndërsa vizitoja njerëzit e shtëpisë, më shoqëronte një studente e gjuhës angleze, e cila me shumë durim më interpretonte fjalët e vendasve pasi njohuritë e mia të greqishtes dhe shqipes ishin të pakta. Në fillim të vizitës tonë përdorja pyetësorë të hapur me qëllim që të dëgjoja atë çfarë vendasit donin të më thonin dhe mbi të gjitha se si donin ose mendonin që duhet ta përfaqësonin veten tek unë. Pjesa më e madhe përmendin fenë e tyre Ortodokse, me të cilën përfaqësoheshin ndryshe nga »Turku« ose »Alvano«, natyrën e tyre punëtore, çështjen e emigrimit dhe mungesën e të rinjve në fshat, shpirtin e tyre luftarak për gjatë historisë, autonominë e zonës së tyre në kohërat e pushtimit Otoman, mundësinë e »lëvizjes së lirë« jashtë kufijëve shqiptarë, autoktonizmin e tyre, grek ose shqiptar. Disa prej tyre paraqesin vetveten duke shpjeguar rrënjët e vllazërisë së tyre (*fis* ose *soji*) dhe fiset (çeta ose barku) që kryeshisht mbi bazën e historive të thëna prej gjyshërve të tyre, shënimeve historike të dëgjura dhe diskutuara në kafenetë vendase ose të lexuara në librat e historjanëve vendas. Përveç mbledhjes së të dhënave të regjistrimit të popullatës, kuptova se shumica e martesave bëheshin dhe ende bëhen brenda fshatit (brezi midis 1930 deri 1960 [101 çifte] 80% e martesave brenda fshatit, 5% me anëtarët e fshatrave rreth zonës së Himarës dhe 15% me banorët e rrethve të tjera të Shqipërisë; ndërsa nga 1960 dhe në vazhdim [274 çifte] kishte 50% përqind të martesave brenda fshatit, 11% me fshatrat rreth zonës së Himarës, 24% me banorët e rrethve të tjera të Shqipërisë, 2.5% me shtetas Grek, dhe 1,4% me shtetas të vendeve të tjera të Europës dhe Amerikës).

Duke parë këto të dhëna, kuptova se në studimin tim mbi perceptimin social dhe kulturor të hapësirës dhe vendit në Dhërmi/Drimades, do të kisha të bëja edhe me koncepte të tjera, si etniciteti, nacionalizmi dhe historitë e diskutueshme.

Që prej 1960 etniciteti u bë shqetësimi kryesor i antropologjisë sociale dhe ende është në qendër të punës së saj kërkimore (shih Eriksen 1993: 1). Fjala »etnike« vjen nga fjala Greke *ethnos* (e cila vjen nga fjala *ethnikos*) që fillimisht do të thoshte idhulltar ose pagan (Williams 1976: 199). Në këtë kuptim ajo përdoret në gjuhën Angleze që prej gjysmës së shekullit të katëmbëdhjetë deri në gjysmën e shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur gradualisht filloi t'i referohet karakteristikave raciale. Në Shtetet e Bashkuara termi etnik nisi të përdoret rreth Luftës së Dytë Botërore si një term i njerëzishm që u referohej Hebrejve, Italianëve, Irlandezëve dhe popujve të tjerë të konsideruar inferiorë ndaj kolonizatorëve mbizotërues Britanikë. Që prej 1960-es grupet etnike dhe etniciteti janë bërë fjalë familjare në antropologjinë sociale Anglofone. Gjatë viteve antropologjia, sociale ka zhvilluar këndvështrime të ndryshme për studimin e etnicitetit, por të gjitha të bazuara mbi faktin se etniciteti ka të bëjë me klasifikimin e njerëzve dhe me marrëdhëniet në grup. Megjithatë në gjuhën e përditshme etniciteti shpesh kuptohet bashkë me çështjet e minoritetit dhe marrëdhëniet racore, në antropologjinë

sociale i referohet aspekteve të mardhënieve midis grupeve që e konsiderojnë veten dhe shikohen nga te tjeret si te ishin te ndryshëm nga pikëpamja kulturore (shih Eriksen 1993: 4). Eriksen (1993) shkruan se fakti i parë i etnicitetit është aplikimi i dallimeve sistematike midis personave që ndodhen brenda grupit dhe atyre që janë jashtë tij, pra, midis »Ne« dhe të »Tjerët«. Për më tepër Erikson thotë se etniciteti është formuar përmes kontakteve sociale, ndërsa dy ose më shumë grupe e konsiderojnë vetveten ndryshe nga gjuha, feja, sistemi farefisnorë, nocione të origjinave të përbashkëta dhe dallimet të tjera që janë konsideruar pjesë e simbolikës etnike (shih ibid.: 18 dhe 68).

Ethniciteti shpeshherë kuptohet si marrëdhënie e konceptit të kombit edhe pse të dy konceptet bazohen në ngjashmëritë kulturore, termi nacionalizëm në kontrast me etnicitetin përcaktohet nga mardhëniet e tij me shtetin. Dallimi kryesor midis ethnicitetit dhe nacionalizmit qëndron në natyrën e kufijve. Nacionalizmi i referohet kufijve politikë, që mund ose jo të korespondojnë me kufijtë kulturorë, ndërsa etniciteti i referohet rreptësisht kufijve kulturorë të cilët në shumë raste ndryshojnë nga ata politikë. Shumë antropologë social shpjegojnë etnicitetin si një menyrë »nismeje« të nacionalizmit. Gellner (1983) e përcaktoi si një lloj ideologjie etnike e cila mbështet mendimin se grupi i tyre duhet të mbizotërojë shtetin. »Prandaj nje komb-shtet është një shtet i dominuar nga një grup etnik, shënuesit e identitetit të së cilit (si gjuha ose feja) janë shpesh të ngulitura në simbolizmin dhe legjislacionin zyrtar« (Eriksen, 1993: 99). Sikurse Gellner, Anderson (1991) vazhdon me mendimin se kombi është një komunitet politik i imagjinuar. Me fjalën »imagjinuar«, ai nuk do të thotë domosdoshmërisht i shpikur, sikurse i quan në fakt ai ata njerëz, që janë anëtarë të një kombi (fizikisht) dhe nuk i njohin të gjithë bashkëkombësit e tyre, megjithëse ideologjikisht ata konsiderohen si pjesë e një komuniteti (Eriksen 1993: 100). Mbi të gjitha »studimet e etnicitetit në nivelin e bashkësive të vogla, së bashku me studimet e nacionalizmit në nivele shtetërore, theksojnë se identitetet etnike ose nacionale janë ndërtime; ato nuk janë natyrale« (ibid.). Kjo do të thotë se nocionet e nacionalizmit dhe etniciteti nuk janë akte natyrale siç perceptohen shpeshherë, por ndërtime sociale të krijuara nga një grup i veçantë njerëzish.

Në të njëjtën mënyrë etniciteti dhe nacionalizmi është gjithashtu historia që në antropologjinë sociale kuptohet si një ndërtesë sociale. Të dy identitetet etnike dhe kombëtare bazohen në nocionet e origjinave të përbashkëta. Prandaj interpretimet e historisë janë të rëndësishme për ideologjitë që kërkojnë të justifikojnë, forcojnë dhe të ruajnë identitete të veçanta etnike dhe kombëtare (shih ibid.: 59). Qëkurse historia u bë pjesë e njohurive themelore, ideologjive të etnicitetit apo kombit, komunitetit lokal, shtetit ose lëvizjeve »nuk është ajo çfarë tashmë është ruajtur në kujtesën popullore, por ajo që është zgjedhur, shkruar, pikturuar, popullarizuar dhe institucionalizuar prej atyre në këtë funksion« (Hobsbawm dhe Ranger [1983] 2002: 13). Për më tepër Hobsbawm and Ranger (1983) vërejnë se »të gjithë historianët me çfarëdolloj objektivi merren me këtë proces aq shumë, sa dhe ndihmojnë me vetëdije ose jo për krijimin, zbrëthimin dhe ristrukturimin e imazheve të së shkuarës, të cilat i takojnë jo vetëm botës së kërkimeve shkencore, por edhe sferës publike të njeriut si qenie politike« (ibid.).

Mbi të gjitha në të gjitha anët e botës ka shumë grupe njerezish që e quajnë veten të ndryshem nga grupet përreth ose nga shteti ku ata janë vendosur. Të gjithë ata mund ta

identifikojnë veten me termat e etnicitetit, nacionalizmit dhe historisë së diskutueshme. Në të njëjtën kohë të gjithë ata mund të shtojnë disa nga të veçantat e tyre (tiparet dalluese) në përcaktimin e këtyre termave. Mbi të gjitha etniciteti, nacionalizmi dhe historia, janë terma që shfaqen kryesisht në diskutimet akademike dhe politike. Prandaj, ato nuk mund të korrespondojnë plotësisht me përkufizimet e grupeve të veçanta për identitetin dhe përkatësinë. Kështu që, disiplina antropologjike bashkohore sugjeron t'i referohemi me terma që përdoren në zonat përkatëse, meqë ato janë mënyra më e mirë për të përshkruar sintezën e »asaj çfarë po ndodh« në këtë komunitet të veçantë.

Himariotët të cilët sipas vëzhgimit tim, pretendojnë identitetin e tyre të dallueshëm, janë vetëm një nga më shumë se 900 grupet lokale në të katër anët e botës, që e konsiderojnë veten dhe konsiderohen nga të tjerët si të ndryshëm nga pikëpamja kulturore ([http://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_ethnic\\_groups](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_ethnic_groups)). Disa prej tyre po luftojnë për njohjen e tyre kombtare, për dallshmërinë dhe ndarjen nga shteti si Nuba në Sudanin jugor; të tjerë qëndrojnë të panjohur ose të marginalizuar, si Ukljani në luginën Kanalska në kufirin Italo-Sloven-Avstriak; disa prej tyre janë quajtur si minoritete si Indianët Yamomamö të Amerikës Jugore; ndërsa disa po harrohen pothuajse si të zhdukur si Nutka vendas të Kanadasë. Të gjithë kanë historitë e tyre dalluese dhe pretendimet të cilat bazohen në »gërmimin« thellë në të shkuarën, me qëllim që të gjejnë »fakte« historike për origjinën e tyre. Këto »fakte« janë konsideruar si përgjigje dhe zgjidhje për problemet e tyre bashkëkohore. Duke kërkuar rrënjët e origjinës së tyre dhe duke iu referuar autoktonizmit, ata po sjellin ndër mend historitë gojore (»stories«) të thëna nga gjyshërit ose të dëgjura nga bashkëfshatarët; duke iu referuar librave të historisë; dhe duke kërkuar origjinën e mbiemrave të fshatit. Meqë pothuajse çdo anëtar i grupit lokal mban versionin e tij të ndryshëm të historisë mund të them se zona e Himarës është vendi i historive të diskutueshme. Këto grindje po sjellin tensione të ndryshme që mund të shihen në nivel të brendshëm dhe të jashtëm, në nivel kombëtar dhe ndërkomëtar. Besoj se Himariotët do të ishtë më mirë të përqëndroheshin në zgjidhjen e problemeve konkrete për zhvillimin e tyre të ardhshëm se sa të merren me këto grindje. Prandaj e shoh këtë konferencë si një shembull të mirë dhe si një hap të rëndësishëm drejt zgjidhjes konstruktive të së ardhmes së Himariotit e cila indirekt do të ndihmojë të zgjidh çështjet e identitetit dhe përkatësisë.

## BIBLIOGRAFI

Eriksen, Thomas Hylland (1993): *Ethnicity and Nationalism. Anthropological Perspectives*. London: Pluto Press.

Gellner, Ernest (1983): *Nations and Nationalism*. Oxford: Blackwell.

Gupta, Akhil and James Ferguson (1997): *Beyond »Culture«: Space, Identity, and the Politics of Difference*. In Gupta, Akhil and James Ferguson (eds.): *Culture, Power, Place. Explorations in Critical Anthropology*, pp. 33-51. Durham: Duke University Press.

Hobsbawm, Eric ([1983] 2002): Introduction: Inventing Traditions. In Hobsbawm, E. and T. Ranger (eds.): *The Invention of Tradition*, pp. 1-14. Cambridge: Cambridge University Press.

Keesing, M. Roger and Andrew Strathern ([1976] 1998): *Cultural Anthropology. A Contemporary Perspective*. Fort Worth: Harcourt Brace College Publishers.

Sanjek, Roger ([1996] 1998): Ethnography. In Barnard, A. and J. Spencer (eds.): *Encyclopedia of Social and Cultural Anthropology*, pp. 193-198. London: Routledge.

Williams, Raymond (1976): *Keywords*. London: Flamingo.

[http://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_ethnic\\_groups](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_ethnic_groups)

### **Anthropological fieldwork in Dhermi/Drimades of Himara area**

In my presentation I will try to present some of my observations and reflections from 12 months of anthropological fieldwork in Dhermi/Drimades of Himara area. Here let me note that I am going to refer to both names Dhermi and Drimades as both of them are used by its inhabitants. As a scholar of social and cultural anthropology a discipline that is based on the study of habits, customs, believes, acts and expressions of particular society I will try to use the concepts and representations that are part of the local discourse. Within the history of human science has often shown up that scientific concepts that refer on a particular society are often too rigid (awkward) to express or describe “what is actually going on” in particular community that is subject of study. Therefore anthropology as a human study tries to avoid the use of official (political, academic) concepts that often turned out to be inappropriate by describing the meaning of the local names and concepts.

Term anthropology derives from a Greek word *anthropos* – people and *logos* – science. Thus anthropology means “human science/study” which is focused on the human customs, habits, common sense, daily life, practices and expressions of a particular, often small-scaled society or community. In broader sense it is “the comparative study of culture and societies” (Keesing and Strathern, 1998: 4). Anthropology consists of three important and interrelated branches that form a so called anthropological triangle: a) ethnography, b) comparison c) contextualisation (see Sanjek, [1996] 1998: 193).

Ad.a) Ethnography is based on a long-term anthropological fieldwork that is conducted by the method of the participant observation. This means that anthropologist has to live with the people that he/she has chosen as a subject of his/her study, learn their language and their mode of life. Anthropologist goes through routines of gathering data that considers: taking census, recording genealogies, learning about the local cast of characters, and querying informants about matter of custom and belief (see Keesing and Strathern, 1998: 8-9). All these, anthropologist notes in his/her fieldnotes that later serve him/her for a further synthesis.

Ad.b) Comparison is the second angle of the anthropological triangle. Fieldnotes gathered on the field are filtered and interpreted by their comparison with other

ethnographies regarding the similar research topic. After conducting fieldwork anthropologist has to read several ethnographies and simulate comparative theoretical thinking, which in turn suggests new problems and interpretations that have to be resolved through further ethnographic fieldwork.

Ad.c) Contextualisation as the last angle of anthropological triangle is based on the placing the theories and comparisons into the broader anthropological context.

In this sense the anthropology is interested in “the search for generalisations and theories about human social behaviour and cultures” (ibid.: 4). Besides this anthropology might also serve for applicative purposes. Applied anthropology often presents a medium that links local people and official institutions or organisations working among them. For example many projects founded by different organisations or institutions that are planning to develop and improve the area (renovation and preservation the cultural heritage, developing the tourism) are often interested for a pilot study that might be done by anthropologists.

Long-term fieldwork is an important part of anthropological research. Its location is often chosen on the scholar’s research topic, general sympathising with a particular country or continent or simply on coincidence. My choice of fieldwork in Dhermi/Drimades of Himara was based on coincidence that resulted from a pleasant chat with my colleague who was inspired by her tourist visit of Albania. After some months of my research in Dhermi/Drimades I could not believe how this coincidence and my curiosity were interpreted in the eyes of some local people who saw my work as a part of the political espionage. Although I was somehow prepared on these kinds of negative understandings of my role in an isolated local community I felt somehow unpleasant. In order to feel more at ease I was constantly comforting my self with the experience from my previous fieldwork that I conducted on one of the islands of Papua New Guinea. There my role of a researcher who often posed funny questions (like what do you eat and how do you dress and a number of other many ‘strange’ why-s) was understood differently. People there thought that I am a ghost of their ancestors. These kinds of perceptions, understandings and reactions to ‘the Other’ (‘the anthropologist’) have been in the anthropological theory widely discussed by several scholars like Eriksen 1993, Gupta and Ferguson 1997 and others. The concept of ‘the Other’ as unknown, unfamiliar, atypical and foreigner is often constructed and understood in the contrast with that of ‘We’ which is known, familiar typical and domestic. In this sense my role as a young, married and childless female anthropologist who came alone to live with the people and be a part of their everydayness was something atypical, unfamiliar and uncommon to Dhermians/Drimadiots.

Local understandings of anthropologist’s role are often important part of anthropological research that helps him/her to understand the broader social and cultural context of the people he/she is studying. Therefore anthropologist has to focus on what the local people want to tell him/her and how they want to represent themselves. When anthropologist enters in the field he/she has to do preliminary research plan, which he has later to ‘forget’ in order to focus on the people’s words and acts. In other words anthropologist has to find out ‘what is actually going on’. Thus, when I came to

Dhermi/Drimades I had to 'switch off' my research plan that was referring to the study of social and cultural perception of the space and place in Dhermi/Drimades of Himara area. In my plan I was asking myself how Dhermians/Drimadiots perceive, express and enact the place and landscape where they live, dwell and travel. In anthropological theories of place and space it is widely known that such local representations of place and landscape can be often different from political or national representations which are in many contexts (especially in postcolonial and post communistic) lived and thought as a common sense. Anthropology as a human discipline tries to expose such common sense 'pit-faults' in order to avoid possible conflicts which can sometimes result in serious cultural, social, historical or political tensions.

In December 2005 when I came to Dhermi/Drimades I began my field research with collection of census data. This I did in order to study the way of social structure (kinship system) and present myself and my research to the local community. When visiting the households I was accompanied by student of English language who patiently interpreted me the words of the local people as my command of Greek or Albanian was very poor. At the beginning of our visit I used open questionnaires in order to listen to what the local people wanted to tell me and above all how they wanted or thought they should represent themselves to me. Majority of them mentioned their Orthodox religion in which they found themselves different from 'Turku' or 'Alvanus', their hard working nature, emigration issue and the absence of young people in village, their fighting spirit throughout their history, autonomy of their area in the times of Turkish conquest, possibility of 'free movement' through the Albanian borders, their autochthonism, Greekness or Albanianess. Some of them (re)presented themselves in explaining the roots of their brotherhoods (*fis* or *sojji*) and tribes (*çeta* or *barku*) that were mainly based on the stories told by their grandfathers, historical accounts heard and discussed in the local cafeterias or read in the books of local historians. Besides that in collecting the census data I realised that majority of marriages were and are still done within the village (generation between 1930 and 1960 [pattern 101 couples] 80% of marriages within the village, 5% with the members of the neighbouring villages of Himara area and 15% with the residents of other places in Albania; while in the 1960 and on [pattern 274 couples] there were 50% of marriages within the village, 11% with the neighbouring villages of Himara area, 24% with the residents of other places in Albania, 2,5% with Greek citizens, and 1,4% with citizens of other EU countries and America).

Upon this data I realised that in my study of social and cultural perception of space and place in Dhermi/Drimades I will have to deal with the concepts such as ethnicity, nationalism and contested histories.

Since the late 1960s ethnicity became the main preoccupation of social anthropology and it still remains an important focus of its research (see Eriksen, 1993: 1). The word 'ethnic' derives from the Greek word *ethnos* (which in turn derived from the word *ethnikos*) that originally meant heathen or pagan (Williams, 1976: 199). It was used in this sense in English language from the mid 14<sup>th</sup> till mid 19<sup>th</sup> century when it gradually

began to refer to 'racial'<sup>1</sup> characteristics. In the United States the term 'ethnic' came into use around the II World War as a polite term referring to Jews, Italians, Irish and other people considered inferior to the dominant British settlers. Since 1960 ethnic groups and ethnicity have become household words in Anglophonic social anthropology. Within years social anthropology has developed several approaches to the study of ethnicity. All of them agree that ethnicity has something to do with the classification of people and with group relationships. Although in everyday language ethnicity is often understood together with minority issues and race relations, in the social anthropology it refers to aspects of relationships between groups that consider themselves, and are regarded by others, as being culturally distinctive (see Eriksen, 1993: 4). The first fact of ethnicity, writes Eriksen (1993), is the application of systematic distinctions between insiders and outsiders; between 'We' and 'the Other'. Furthermore Eriksen says that ethnicity is constituted through social contact whereas two or several groups regard themselves distinctive by language, religion, kinship system, notions of shared origins and other differences that are considered a part of ethnic symbolism (see *ibid.*:18 and 68).

Ethnicity is often understood in relation to the concept of nation. Although both concepts are based on the cultural similarities the term nationalism in contrast to ethnicity is defined in its relationship to the state. The main difference between ethnicity and nationalism lies in the nature of the boundaries. Nationalism refers to the political boundaries that can correspond or not with the cultural ones, while ethnicity refers strictly to the cultural boundaries which in many cases differ from political. Many social anthropologists explain ethnicity as a 'starting' mode of nationalism. Gellner (1983) defined it as a kind of ethnic ideology which holds that their group should dominate the state. "A nation-state, therefore, is a state dominated by an ethnic group, whose markers of identity (such as language or religion) are frequently embedded in its official symbolism and legislation" (Eriksen 1993: 99). Similarly to Gellner, Anderson (1991) continues that nation is an imagined political community. With the word imagined he does not necessarily mean invented as he refers on the fact that people who are members of one nation never (physically) know all fellow-members although that ideologically they will consider them as part of one community (Eriksen 1993: 100). Above all "both studies of ethnicity at the local community level and studies of nationalism at the state level stress that ethnic or national identities are constructions; they are not 'natural'" (*ibid.*). This means that the notions of nationalism and ethnicity are not natural acts as they are often perceived but social constructions created by particular group of people.

Likewise ethnicity and nationalism, it is also the history that is in social anthropology understood as a social construction. Both, ethnic and national identities are based on the notions of shared origins. Interpretations of history are therefore important to ideologies that seek to justify, strengthen and maintain particular ethnic and national identities (see *ibid.*: 59). Since history became part of the fund knowledge or ideology of ethnicity or nation, local community, state or movement "is not what has actually been preserved in popular memory, but what has been selected, written, pictured, popularised and institutionalised by those whose function is to do so" (Hobsbawm and Ranger [1983]

---

<sup>1</sup> The term 'racism' is deliberately put in inverted commas in order to stress that it has dubious descriptive value.

2002: 13). Furthermore Hobsbawm and Ranger (1983) note that “all historians, whatever else their objectives, are engaged in this process inasmuch as they contribute, consciously or not, to the creation, dismantling and restructuring of images of the past which belong not only to the world of specialist investigation but to the public sphere of man as a political being” (ibid.).

Above all, throughout the world there are many local groups that recognise themselves distinct from the neighbouring groups or the state where they are located. All of them could identify themselves with the terms of ethnicity, nationality and contested history. At the same time all of them could also add some of its particularities (distinctive features) to the definition of these terms. Above all, ethnicity, nationality and history are terms that appear mostly in academic and political discourse. Therefore they can never fully correspond with the local definitions of identity and belonging. Thus, contemporary anthropological discipline suggests referring on the local terms, as they are the best mode to describe and synthesise ‘of what is going on’ in particular local group. Himariots, who according to my observation claim their distinct identity there are only one of more than 900 local groups throughout the world that consider themselves, and are regarded, as being culturally distinctive (see [http://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_ethnic\\_groups](http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_ethnic_groups)) by other groups. Some of them are struggling for their national recognition of their distinctiveness and separation from the state like Nuba in the South Sudan, others are staying unknown and marginal like Ukljani in Kanalska Valley on the Italo- Slovenian-Austrian border, some of them had been recognised as minorities like Yamomamö Indians of South America, while some are being forgotten as they almost died out like Nutka indigenous people of Canada. All of them have their distinct stories and claims which are based on ‘digging’ deep down/back in the past in order to find the historical ‘facts’ about their origins. The later are considered as answers and solutions for their contemporary problems. In seeking their roots of origin and referring on autochthonism they are recalling the oral histories (‘istories’) told by their grandfathers or heard by their fellow-villagers; referring on history books; and seeking the origin of the village surnames. As almost each member of the local group holds its distinct version of history, I could say that Himara area is a place of contested histories. These contestations are bringing several tensions that can be seen on inter and intra-local level, national and international level. I believe that instead of such contestations Himariots would be better of in concentrating on how to solve concrete questions about their future development. Thus I see this conference as a good example and important step towards the constructive solution of Himariot future, which will then indirectly help to solve also their issues of identity and belonging.